



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1893/12 Prot.

Vlorë më, 17 . 07 .2025

VENDIM

Nr. 81, datë 17.07.2025

PËR

**MIRATIMIN E KUOTAVE TË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT
BACHELOR NË SHKENCA ARKITEKTURORE PËR TRASHËGIMINË (GJUHË
ANGLEZE) PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Në mbështetje të nenit 25, pika 8, nenit 38, të ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma f, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.12 të MAS datë 30.06.2023, "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në IAL", Urdhër të MAS nr.456, datë, 14.08.2023, si dhe referuar shkresës 1887/1, prot, datë 17.07.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 17.07.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në programin e përbashkët të studimit Bachelor në "Shkenca Arkitekturore për Trashëgiminë" (në gjuhë angleze), sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike.
3. Kuotat e miratuara i përcillen MAS dhe QSHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr.Aurela Saliaj

